



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË**

Data: 11/01/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Shfrytëzimi inteligjent i energjisë(Projekti i eficientës së energjisë) “

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Instalime inxhinerike elektrike 45315100-9

Instalime të pajisjeve të ndriçimit rrugor 45316110-9

Punime rrugore 45233140-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

78.357.756 (shtatëdhjetë e tetë milion e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë)lek,pa tvsh.

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 629 date 15.07.2015 ''Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre'', i ndryshuar, dhe ne analizat teknike te cmimeve te hartura nga specialist i fushes Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ''Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit'', Vendimin Nr. 664, datë 26.9.2012 ''Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave ''Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit'' .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **BASHKIA KORÇË**ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat në pikat “a” dhe “b” bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës që prokurohet. që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2.b dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të

Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të** vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me;
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Shenmi lidhur me punet që do të konsiderohen punë të ngjashme është vendosur me kërkesë të ekipit të SEMP-it.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më

sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Kategoria Klasifikimi Emertimi i kategorise

N.P – 1 A Punime germimi ne toke

N.P – 11 C Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

N.P – 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues. Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjiise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë e respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Zërat Gjurmim e mbushje dhe me krah për kanale kategoria III, h = 1 m	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që përfshihen në këtë kategori është me e vogël se 20 milion
N.P – 11	Ndërtim për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	Të gjitha zërat që kanë të bëjnë me punimet elektrike	C 51-100 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që përfshihen në këtë kategori është me e madhe se 51 milion lekë.
N.P – 4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	shtrese rere	A, 0-20 milionë lekë	Vlera e punimeve të parashikuara në preventiv dhe që përfshihen në këtë kategori është me e vogël se 20 milion
		mbulim kanali		
		Vendosje bordure 15 X 30 cm ekzistuese		
		Shtrese stabilizanti t=10cm, granil, gure		
		Shtrese binderi ,4cm, me makineri		
		Shtrese asfaltobetoni 3cm, me makineri		
		vendosje pllaka shtrese		
		f.v.bordure bordure 15x35		
		Shtrese stabilizanti t=10cm, granil, gure		
		Shtrese binderi ,3cm, me makineri		
		Shtrese asfaltobetoni 3cm, me makineri		

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

- Inxhinier Elektrik 1(një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Per te vertetuar personelin kryesor duhet:

I.diploma

II- kontrata e punes

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

Inxhinier Topograf 1(një)

Dokumentacioni që duhet të paraqesin.

I.diploma

II- kontrata e punes

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, te perfshire ne listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

Elektracist- 3 punonjës
Dy ndertues teknik te mesem

Për stafin e sipërcituar të paraqitet:

I. Kontrata e punes

II. Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve)

III. Diplome e shkollës të mesme

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM Nr 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, Udhezimit Nr 2 date 13.05.2021 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”,i ndryshuarligjit nr.10327 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e ketyre kriterëve eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve.

Konkretisht:

- Inxhinieri i Ndertimit nevojitet per ndjekjen e realizimit e punimeve te ndertimit të parashikuara në projekt sipas rregullave dhe kushteve teknike të zbatimit .

- Inxhinieri Elektrik nevojitet per ndjekjen e realizimit të punimeve elektrike të parashikuara në preventiv, në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike.
- Inxhinieri topograf është kërkuar me qëllim realizimin e rlevimeve topografike te domosdoshme gjatë zbatimit.

Kërkesa lidhur me punojësit e specializuar/të kualifikuar është vendosur mbështetur në zerrat dhe volumet e preventivit dhe afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve.

Kërkesa specifike për Stafin e punonjësve te specializuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar. Punëtoret e specializuar (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Konkretisht:

Elektracist- 3 punonjës- per realizimin e punimeve elektrike ne objekt,sipas preventivit te punimeve. Janë kërkuar 3 punonjë për shkak të volumit të konsiderueshëm të punimeve,afatit dhe për shkak se është parashikuar të punohet në 10 objekte që përfshijnë qytetin Korçë dhe njësitë administrative .

Dy ndertues teknik te mesem-per realizimin e punimeve ndertimore ne objekt. Janë kërkuar 2 punonjës për shkak të volumit të konsiderueshëm të punimeve,afatit dhe për shkak se është parashikuar të punohet në 10 objekte që përfshijnë qytetin Korçë dhe njësitë administrative .

2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **24 persona**, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar nëpërcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.7Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronesia
Kamion me kapacitet mbajtes	Cope 3	ne pronesi ose me qira

deri 10 ton		
Autovinc	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Vinc me kosh	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Rul	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Tokmak elektrik	Cope 3	ne pronesi ose me qira
Prerese/Sharrë asfalti	Cope 2	ne pronesi ose me qira
Bitumatrice	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Aprat Luxmeter per fluksin e ndicimit	Cope 1	ne pronesi ose me qira
Betonierte te vogla	Cope 3	ne pronesi ose me qira

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

-Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet, certifikata e pronesise , leja e qarkullimit,certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit.

Kur jane me qera te paraqiten: kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi, e shoqeruar me lejen e qarkullimit ,certifikaten e pronesise, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

-Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk shenohen ne regjistra publike ofertuesi duhet te paraqesë dokumente qe vertetojne pronesine e mjeteve/pajisjeve dhe ne rast se jane me qera duhet te kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi e shoqeruar me dokumentacionin qe verteton pronesine e tyre.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit

nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Numri i stafit kryesor, mbeshtetes dhe punonjës të specializuar është llogaritur ne baze te zberthimit te grafikut te punimeve dhe zberthimit te preventivit dhe natyres se objektit. Numri prej 24personash përfshin personelin kryesor, drejtues teknik, punonjës të specializuar / kualifikuarsi dhe numrin e punëtorëve të thjeshtë përlllogaritur nga zbërthimi i preventivit, grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit.

Konkretisht nga llogaritjet e bera nga specialisti i fushes rezulton se :

Sasia e oreve tepunessipas manualit dhe analizave teknike është 22198 ore. Llogaritja e numrit te punonjesve ne varesite oreve tepunes dhe afatit te kontrateseshtesi me poshte:

Totali orë pune + orë makineri	22198
Ditë pune (orë pune/8)	2775
Nr. i punëtorëve (ditë pune/132ditë)	21
Ing. ndërtimi	1
Ing.elektrik	1
Ing topograf	1
Numri i punëtorëve gjithsej	24

Lidhur me mjetet edhe pajisjet teknike:

Pajisjedhemjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe ishin të nevojshme për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter u vendos duke patur parasysh natyrën dhe volumnin e punimeve të parashikuara në preventiv .

Konkretisht:

Kamion me kapacitet mbajtes deri 10 ton- Nevojiten per transportin e materialeve. Jane kerkuar 3 cope për shkak të volumnit të konsiderueshëm të punimeve,afatit dhe për shkak se është parashikuar të punohet në 10 objekte që përfshijnë qytetin Korçë dhe njësitë administrative .

Autovinc- Nevojitet për çmontim dhe vendosje shtyllash

Vinc me kosh- Nevojitet për montimin e ndricuesave .Duhet dy per shkak të sasisë të konsiderueshme të ndricuesave.

Rul –Nevojiten përngjeshjen e binderit dhe asfaltit Duhet dy per shkak të volumnit të të punimeve dhe afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Tokmak elektrik-Nevojiten për ngjeshjen e nenshtresave rrugore. Duhet tre për shkak të volumit të të punimeve dhe afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Prerese/Sharrë asfalti- Nevojiten për prerjen e asfaltit ekzistues ku do të vendosen kabllot. Duhet dy për shkak të volumit të të punimeve dhe afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Bitumatrice- Nevojitet për lidhjen e shtresave të binderit dhe asfaltit

Aprat Luxmeter për fluksin e ndicimit-Nevojitet për matjen e intensitetit të ndricimit.

Betoniere: Nevojiten për vendosjen e bordurave. Duhet tre për shkak të volumit të të punimeve dhe afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

2.2.8 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë :

- Certifikatën ISO 9001: 2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”

Certifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Ne rast se dokumentet e mesipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të

kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë..

2.2.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për materialet e mëposhtme në mënyrë që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në specifikimet teknike.

1. Autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit .

2. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun/et ose skedat teknike për të gjitha mallrat e paraqitura në tabelën më poshtë, të cilat duhet të përputhen me përshkrimin e bërë në specifikimet teknike dhe çertifikatë/deklaratë konfirmimi CE për të gjitha mallrat e paraqitura në tabelën më poshtë.

Në rast se dokumentet e mësipërme janë në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Nr	Përshkrimi
1	Ndriçues dekorativ led/ 8,326 lumen/ 3000k
2	Ndriçues dekorativ led/ 3,363 lumen/ 3000k
3	Ndriçues dekorativ led/ 7,450 lumen/ 3000k
4	Ndriçues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k
5	Ndriçues led/ 142w/ 3000k + krahun
6	Ndriçues led/ 8,600 lumen/ 3000K
7	Kuader komandimi
8	Kabell 3x1.5 mm ²
9	Kabell 4x6 mm ²
10	Kabell 4x10 mm ²
11	Percjelles tokezimi bakri S=16mm ²

4. Përveç sa më sipër, operatori duhet të dorëzojë edhe raportet e testimit për shkallën e mbrojtjes dhe izolimin për materialet e mëposhtme:

- Ndriçues dekorativ led 7,450 lumen/ 3000k
- Ndriçues dekorativ led 3,363 lumen/ 3000k

- Ndricues dekorativ led 8,326 lumen/ 3000k
- Ndricues led, 142w, 3000k + krahun
- Ndricues led 8,600 lumen/ 3000K
- Ndricues dekorativ led/ 2,796 lumen/ 3000k

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Kërkesa e mësipërme vlerësohet e nevojshme ne kushtet kur objektivi kryesor i këtij projekti është realizimi **futja e teknologjisë led** ne rrugët,sheshet,lulishtet,bazuar kjo në standartet shqiptare dhe në harmoni me standartet europiane.

Për autoritetin kontraktor është e nevojshme që të garantohet paraprakisht që ofertuesit kanë mundësi dhe kapacitete për të siguruar materialet e kërkuara sipas specifikimeve teknike.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Projekti dhe Specifikimet Teknike janë bashkëlidhur dokumentave të tenderit.

Shënim:

Kjo kontratë bashkëfinancohet nga SECO dhe MIE bazuar në Marrëveshjen kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës të Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran “Për Bashkëpunimin teknik,financiar dhe humanitar” te lidhur ne daten 11.05.2007 dhe e ratifikuar me Ligjin Nr 9801 datë 13.09.2007“, Marrëveshjen datë 12.11.2021 “Mbi dhenien e asistencës teknike dhe financiare në kuadrin e “Projektit të Bashkive me Energji Inteligjente”(SEMP),të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe Konfederatës Zvicerane, Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Sekretariatit të Shteti Zviceran për Çështjet ekonomike (SECO) “Për zbatimin e projektit per bashkitë me shfrytëzim inteligjent te energjisë (SEMP)” dhe Manuali i operimit datë 10.04.2022 “Investime me zbatim të shpejtë për ndriçimin LED të rrugëve:Proceset e realizimit të punimeve dhe flukset financiare” i përgatitur nga Konsorciumi SEMP.

Bazuar në sa më sipër,dokumentat e tenderit janë shqyrtuar paraprakisht nga Konsorciumi i Zbatimit të SEMP(SEMP-Projekti per Bashki me Energji Inteligjente) dhe kanë marrë aprovimin nga SECO (SECO-Sekretariati i Shtetit Zviceran per Çështjet Ekonomike të Konfederatës Zvicerane).

NJESIA E PROKURIMIT

